



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit.
- II. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 04771-0, me sip. 80m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-04771-0, Zona kadastrale, Prishtinë, në pronësi të Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit, me destinim infrastrukturë rrugore, sipas Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-374, dt.03.04.2008, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit zhvillimor urban "Tophane", i miratuar me vendimin nr. 01, nr. 035-181427, dt.24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, kurse prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 04722-0, me sip. 80 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04722-0, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese, ndërtim sipas Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-374, dt. 03.04.2008, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit zhvillimor urban "Tophane", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, dhe për t'iu shmangur pasojave të larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjyqësore.



- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
kopjet e planit dhe
certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-206968/22 më, 26.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Pronari i pronës private, sipas kërkesës nr. 13-464/01-267594/21, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private e cila shfrytëzohet për interes publik - rrugë, gjegjësisht është parcela nr. 04771-0, me sipërfaqe prej: 80m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit,, me destinim interes publik - rrugë, sipas Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-374, dt. 03.04.2008, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit zhvillimor urban "Tophane", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale PSH, KK Prishtinë, me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për shkak se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t'u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijën nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 04722-0, sipërfaqe prej: 80m², Zona kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese - ndërtim, sipas Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-374, dt. 03.04.2008, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Planit zhvillimor urban "Tophane", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

